

Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri

Prill 2019


Tiranë, më 23 Maj 2019: Hyrjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj në Shqipëri, në muajin Prill 2019, janë 874.156. Krahasuar me Prill 2018, ky tregues rezulton me rritje 11,9 %.

Në Prill 2019, hyrjet e shtetasve të huaj në vend janë 410.060. Krahasuar me Prill 2018, ky numër është rritur me 16,6 %.

Numri i shtetasve të huaj të hyrë në vendin tonë në katërmujorin e parë 2019 është 1.105.087, duke u rritur me 7,4 %, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2018. Në Prill 2019, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Spanja ka pasur rritjen më të madhe me 124,2 %, ndërsa uljen më të ndjeshme e ka pasur Mali i Zi me 3,2 %.

Në katërmujorin e parë 2019, ndër vendet që kanë hyrjet më të larta të shtetasve në Shqipëri, Zvicra ka pasur rritjen më të madhe me 29,5 %, ndërsa uljen më të ndjeshme e ka pasur Kosova me 6,4 %.

Fig. 1 Lëvizjet e shtetasve në Shqipëri



Daljet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj nga vendi, gjatë muajit Prill 2019, janë 854.355, duke shënuar një rritje me 5,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Daljet e shtetasve shqiptarë nga territori i Shqipërisë, gjatë muajit Prill 2019, janë 469.788. Krahasuar me Prill 2018, ky numër është rritur 4,1 %. Daljet e shtetasve të huaj nga territori i Shqipërisë gjatë muajit Prill 2019, janë 384.567. Krahasuar me Prill 2018, ky numër është rritur 6,1 %.

Numri i shtetasve shqiptarë të dalë nga territori i vendit tonë në katërmujorin e parë 2019, është 1,719,591, duke u rritur 10,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tab. 1 Lëvizjet e shtetasve shqiptarë dhe të huaj

Periudha	Prill 2018	Prill 2019	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Prill 2018	Janar-Prill 2019	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Gjithsej	781.404	874.156	11,9	2.487.700	2.691.878	8,2
Shqiptarë	429.794	464.096	8,0	1.459.201	1.586.791	8,7
Të Huaj	351.610	410.060	16,6	1.028.499	1.105.087	7,4
Dalje Gjithsej	813.755	854.355	5,0	2.634.158	2.836.440	7,7
Shqiptarë	451.147	469.788	4,1	1.563.003	1.719.591	10,0
Të Huaj	362.608	384.567	6,1	1.071.155	1.116.849	4,3

Tab.2 Hyrjet e shtetasve të huaj

Shtetet	Prill 2018	Prill 2019	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Prill 2018	Janar-Prill 2019	Ndryshimi vjetor (%)
Kosovë	106.698	112.294	5,2	337.721	316.221	-6,4
Maqedoni	50.700	53.963	6,4	148.364	158.861	7,1
Greqi	52.024	55.224	6,2	152.252	164.184	7,8
Itali	24.785	30.131	21,6	81.181	88.414	8,9
Angli	7.162	9.348	30,5	20.424	20.755	1,6
Mali i zi	36.152	34.986	-3,2	116.870	115.485	-1,2
Poloni	3.434	3.879	13,0	4.653	5.228	12,4
SHBA	5.726	6.837	19,4	15.870	20.364	28,3
Spanjë	858	1.924	124,2	2.498	3.173	27,0
Gjermani	8.167	13.447	64,7	17.634	21.398	21,3
Zvicër	3.500	5.541	58,3	7.358	9.530	29,5
Të tjera	52.404	82.486	57,4	123.674	181.474	46,7
Gjithsej/Total	351.610	410.060	16,6	1.028.499	1.105.087	7,4

Tab. 3 Hyrjet e shtetasve të huaj sipas qëllimit

Periudha	Prill 2018	Prill2019	Ndryshimi vjetor (%)	Janar-Prill 2018	Janar-Prill2019	Ndryshimi vjetor (%)
Hyrje Shtetas të Huaj	351.610	410.060	16,6	1.028.499	1.105.087	7,4
I. Personale	344.304	401.372	16,6	1.005.084	1.076.177	7,1
1. Pushime, vizitë tek të afërm etj.	327.508	381.385	16,5	957.759	1.024.530	7,0
2.Trajtim shëndetësor	28	82	192,9	90	219	143,3
3.Qëllime fetare	130	68	-47,7	263	263	0,0
4.Udhëtarë transit	16.638	19.837	19,2	46.972	51.165	8,9
II. Biznes dhe profesionale	7.306	8.688	18,9	23.415	28.910	23,5

Tab. 4 Lëvizjet e shtetasve sipas mënyrës udhëtimit

Periudha	Hyrje gjithsej			Dalje gjithsej		
	Ajër	Det	Tokë	Ajër	Det	Tokë
Prill 2018	108.449	29.685	643.270	106.039	31.340	676.376
Prill 2019	122.791	43.030	708.335	117.493	39.450	697.412
Ndryshimi vjetor (%)	13,2	45,0	10,1	10,8	25,9	3,1
Janar-Prill 2018	384.351	96.686	2.006.663	391.020	118.867	2.124.271
Janar-Prill 2019	417.453	115.616	2.158.809	426.920	144.409	2.265.111
Ndryshimi vjetor (%)	8,6	19,6	7,6	9,2	21,5	6,6

Metodologji

Qëllimi i publikimit të hyrjeve dhe daljeve të shtetasve shqiptarë dhe të huaj sipas mënyrës së udhëtimit (me det, ajër, tokë dhe pikave kufitare) është matja e disa treguesëve statistikorë që lidhen me turizmin.

Përkufizime

Hyrjet: Përfshijnë të gjitha hyrjet e personave në pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Hyrjet janë një koncept që i referohet të gjitha mbërritjeve. Një person që viziton disa vende njëkohësisht gjatë një viti llogaritet çdo herë si një hyrje e re.

Daljet : Përfshijnë të gjitha daljet e personave nga pikat kufitare (me ajër, det dhe tokë).

Daljet masin fluksin e shtetasve që lënë vendin e referencës. Një person që lë vendin e referencës disa herë gjatë një viti llogaritet çdo herë si një dalje e re.

Vizitor: Për qëllime të statistikave të turizmit, termi “vizitor” nënkupton “një person që udhëton në një vend të ndryshëm nga vendi ku ai banon, për një periudhë më pak se 12 muaj dhe qëllimi kryesor i këtij udhëtimi në vendin e vizituar nuk është ai i një veprimtarie fitimprurëse”.

Qëllimi i udhëtimit të vizitorëve dhe turistëve përfshin vizita për:

Qëllime personale të cilat grupohen në:

1. Pushime, vizitë tek të afërm, etj.;
2. Trajtim shëndetësor;
3. Qëllime fetare;
4. Udhëtarë tranzit.

Kategoria e biznesit që përfshin të gjitha bizneset dhe aktivitetet profesionale jashtë ambjentit të zakonshëm.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë administrative dhe sigurohen nga Ministria e Punëve të Brendshme (Policia e Shtetit, Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit).

Të dhënat janë paraprake dhe subjekt rishikimi të vazhdueshëm. Për më shumë referohu: <http://www.instat.gov.al/al/dokumentimi/cil%C3%ABsia-statistikore/> politika e revizionimit statistikor.

Diferencat statistikore misdis hyrje-daljeve të shtetasve Shqiptarë apo të huaj vijnë kryesisht nga:

- Ligjit nr.71/2016 "Për Kontrollin Kufitar", neni 17 "Lehtësimi i verifikimeve Kufitare", ku gjatë sezonit turistik apo fluksit të shtuar, në momentet e hyrjeve të shtetasve në kufi, nuk regjistron shtetasit në hyrje;
- Procedurat lehtësuese që aplikohen për banorët e zonave kufitare të cilët kalojnë kufirin për arsye të aktivitetit të tyre tregtarë, kur kalojnë disa herë brenda ditës, nuk regjistrohen në hyrje;
- Dy-shtetësia që zotërojnë një pjesë e mirë e Shqiptarëve të cilët në momentin e kalimit të kufirit mund të deklarojnë shtetësi të ndryshme në dalje nga ajo në hyrje, etj.